EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8431
E premte, 13 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Bisedimet për paqe në Ukrainë: Përparim diplomatik, por jo paqe

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

LIGJI PËR SPECIALEN RIKTHEHET NË KUVEND, DEPUTETËT DISKUTOJNË PËR RIMIRATIMIN E TIJ




Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar do të jetë pikë e rendit të ditës në seancën parlamentare të së premtes. Partitë politike LV, PDK dhe Aleanca janë pajtuar për procedimin e tij drejt rimiratimit në Kuvend. Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se kanë marrë disa kështilla dhe rekomandime, të cilat, sipas saj, do ta bëjnë ligjin më të fuqishëm dhe juridikisht më të qëndrueshëm ndaj çdo kontestimi të mundshëm në fazat e mëtejshme

AKK-ja UA PËRCJELL DEPUTETËVE KËRKESAT E KOMUNAVE PËR PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2027 F. 7



GUVERNATORI ISMAILI TAKOI PRESIDENTEN SHIROKA-PULA: NË FOKUS STABILITETI FINANCIAR, HAPAT E ARDHSHËM PËR SEPA-N DHE PËRFITIMET E REFORMAVE PËR QYTETARËT DHE BIZNESET F. 3



AKTUALE



171 DITË ME NDOTJE MBI KUFIRIN E LEJUAR: AJRI QË THITH KOSOVA F. 6

RAMA: E KRIJUAM NDËRMARRJEN E RE TË PASTRIMIT, QEVERIA NA BLLOKOI, POR NE GJEJMË ZGJIDHJE F. 6

RRITJA E BUXHETIT PËR SHËRBIME SOCIALE, DOMOSDOSHMËRI PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, GRAVE DHE FAMILJEVE F. 7

EKONOMI



BQK-ja DHE OEK-u PARAQESIN RISITË NË SISTEMIN E PAGESAVE DHE PËRFITIMET PËR BIZNESET F. 8

POSTA E KOSOVËS SHËNON 1,11 MILION EURO FITIM NË VITIN 2025 F. 8

SPORT



RASHICA NË JANAR LARGOHET NGA BESHIKTASHI? F. 11

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

BISEDIMET PËR PAQE NË UKRAINË: PËRPARIM DIPLOMATIK, POR JO PAQE

KIEV, 12 NËNTOR - Negociatat e para trepalëshe mes në të Rusisë, Ukrainës dhe Shteteve të Bashkuara që nga fillimi i këtij viti sollën përparim të kufizuar në aspektin humanitar, por pak rezultate konkrete drejt përfundimit të luftës.

Bisedimet dyditore, të mbajtura në Abu Dabi më 10 dhe 11 nëntor, përfunduan me një marrëveshje në parim për shkëmbimin e një numri të madh të burgosurish të luftës dhe hapën diskutimet për marrëveshje më të gjera të sigurisë evropiane.

Megjithatë, palët duket se nuk janë më afër paqes sesa ishin 48 orë më parë. "Pengesa themelore për përfundimin e kësaj lufte është se asnjëra nga palët ndërluftuese aktualisht nuk sheh mundësi për një marrëveshje paqeje që do t'i garantonte interesat e saj jetike me një kosto më të ulët sesa vazhdimi i luftimeve", thotë Slawomir Debski, profesor vizitues i strategjisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Kolegjin e Evropës në Natolin, me seli në Varshavë. "Ky është ngërçi themelor. Moska dëshiron një paqe që do ta shndërronte agresionin e saj në një fitore më të gjerë strategjike. Ukrainës i duhet një paqe që ia ruan aftësinë për të mbijetuar. Evropa nuk mund ta pranojë kontrollin rus mbi sigurinë evropiane, ndërsa Amerika nuk ka asnjë arsye të qëndrueshme strategjike për ta lehtësuar një gjë të tillë".

Zyrtarët amerikanë i përshkruan negociatat të vështira, por produktive, duke pranuar njëkohësisht se në mes të Kievit dhe Moskës mungon besimi plotësisht.

Megjithatë, bisedimet shënuan një zhvillim të rëndësishëm: Uashingtoni po përpiqet t'i zgjerojë negociatat përtej së ardhmes së Ukrainës, duke përfshirë edhe marrëveshje më të gjera për sigurinë e Evropës. Kjo mund t'i përfshijë qeveritë evropiane në një proces nga i cili deri më tani kanë qenë kryesisht të përjashtuara.

Të dërguarit amerikanë, Steve Witkoff dhe Jared Kushner, pritet të udhëtojnë në Moskë për t'u takuar me presidentin rus Vladimir Putin përpara se të shkojnë në Dublin për bisedime me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy, i cili aktualisht po qëndron për vizitë në Irlandë.

Këto takime do të tregojnë nëse Uashingtoni mund ta shndërrojë aktivitetin diplomatik në përparim domethënës, apo nëse Moska po i shfrytëzon negociatat për të çuar përpara synime më të gjera strategjike, ndërkohë që vazhdon luftën.

Shkëmbimi i të burgosurve sjell përparim

Zyrtarë të lartë amerikanë i thanë Radios Evropa e Lirë më 11 nëntor se marrëveshja për shkëmbimin e një numri të madh të burgosurish të luftës përbënte një sukses.

Një negociator amerikan tha gjithashtu se kishte vërejtur "paksa fleksibilitet" nga të dyja palët gjatë bisedave private, megjithëse nuk dha hollësi.

Një zyrtar i lartë amerikan, i cili foli në kushte anonimiteti, tha se Uashingtoni synonte të ecte përpara gradualisht, duke shtuar se administrata do t'i trajtonte çështjet "hap pas hapi".

Zyrtari paralajmëroi se marrëveshjet e sigurisë për periudhën pas luftës nuk mund të zbatohen pa u arritur fillimisht një marrëveshje për çështjet territoriale dhe mosmarrëveshjet e tjera mes dy vendeve.

Ky kusht nxjerr në pah pengesën kryesore: palët mund të jenë të gatshme të diskutojnë zgjidhje praktike, por vazhdojnë të kenë dallime të mëdha për marrëveshjen politike që nevojitet për t'i dhënë fund luftës.

Zelenskyy tha më 11 nëntor në Dublin se shkëmbimi i propozuar i të burgosurve mund të përfshijë nga 1 000 deri në 1 500 persona nga secila palë.

Megjithatë, ai theksoi se Kievi ka propozuar gjithmonë shkëmbimin e të gjithë të burgosurve, duke thënë se nuk e kupton pse "mijëra të tjerë" duhet të presin në robëri fundin e vuajtjeve të tyre.

Kryenegociatori ukrainas Rustem Umerov pranoi se, pavarësisht prej diskutimeve, dallimet e mëdha mbeten. "Gjatë këtyre dy ditëve palët patën mundësinë t'i paraqesin drejtpërdrejt qëndrimet e tyre dhe mes tyre vazhdojnë të ekzistojnë dallime të konsiderueshme", tha ai.

Kyrylo Budanov, shefi i administratës presidenciale të Zelenskyyt, i përshkroi bisedimet të vështira, por këmbënguli se qëndrimi i Ukrainës nuk ka ndryshuar. Kievi kërkon përfundimin e luftës dhe marrëveshje sigurie që do ta parandalonte një agresion të ri rus.

Moska dha pak sinjale se ishte e gatshme të lëshonte pe për çështjet më të diskutueshme.

Kryenegociatori rus Vladimir Medinsky tha se shkëmbimi i territoreve si pjesë e një marrëveshjeje ishte jashtë diskutimit, sipas medieve shtetërore ruse.

Zelenskyy bëri me dije gjithashtu se delegacioni rus e kishte refuzuar propozimin e Ukrainës për një armëpushim në sulmet ndaj infrastrukturës energjetike, duke thënë se nuk kishte mandat për ta diskutuar këtë çështje.

Paul Saunders, president dhe drejtor ekzekutiv i Qendrës për Interesin Kombëtar dhe ish-këshilltar i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit, i tha Radios Evropa e Lirë se përparimi i arritur deri më tani ishte kryesisht simbolik. "Nuk ka pasur përparim thelbësor", tha Saunders, duke argumentuar se palët nuk janë afruar ndjeshëm drejt një marrëveshjeje të pranueshme për të gjithë.



Çfarë dëshiron Moska?

Saunders ofroi një shpjegim për gatishmërinë e Rusisë për të negociuar, duke argumentuar se Putini vazhdon të besojë se Moska mund ta fitojë luftën përmes rraskapitjes graduale të kundërshtarit.

Rusia është më e madhe dhe më e pasur se Ukraina, ndërsa Kremlini llogarit se Kievi po përballet me trysni gjithnjë e më të mëdha ushtarake dhe ekonomike, ndërkohë që qeveritë evropiane mund ta kenë gjithnjë e më të vështirë ta vazhdojnë mbështetjen e tyre, tha ai.

Në këtë kontekst, negociatat i shërbejnë Moskës për disa qëllime. Ato i mundësojnë të tregojë gatishmëri për bisedime, ta mbajë administratën Trump të angazhuar në procesin e paqes dhe ta zvogëlojë rrezikun që presidenti amerikan, i zhgënjyer nga mungesa e përparimit, ta ashpërsojë qasjen ndaj Rusisë.

Saunders tha se Moska ka interes edhe të hapë tema të reja kur negociatat për çështjet ekzistuese nuk japin rezultate.

Shkëmbimet e të burgosurve dhe marrëveshjet e tjera që kërkojnë lëshime relativisht të vogla ndihmojnë në ruajtjen e ritmit diplomatik, pa e detyruar Kremlinin të heqë dorë nga synimet themelore.

Prandaj, pyetja është se çfarë do të mund ta nxiste Putinin t'i jepte fund luftës, nëse ai beson se koha dhe zhvillimet në fushëbetejë, ashtu siç i paraqet Moska, janë në favor të Rusisë.

Ish-ambasadori amerikan në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), James Gilmore, ofroi një interpretim pak më ndryshe.

Në një prononcim për Radion Evropa e Lirë, ai sugjeroi se kundërsulmet ukrainase ndaj infrastrukturës ruse dhe trysnia ekonomike në rritje mund ta shtyjnë Kremlinin të kërkojë një fitore diplomatike, në vend që ta rrezikojë vazhdimin e një fushate ushtarake gjithnjë e më të kushtueshme.

Gilmore argumentoi se Rusia mund të jetë duke u përpjekur të sigurojë përmes negociatave atë që nuk po arrin ta fitojë në fushëbetejë.

Por ai paralajmëroi se qëndrimet themelore të Moskës dhe Kievit mbeten të vështira për t'u pajtuar. Rusia kërkon një marrëveshje që do të përbënte fitore sipas kushteve të saj, ndërsa synimi kryesor i Ukrainës është mbijetesa dhe mbrojtja nga një agresion i ri.

Gilmore e mirëpriti shkëmbimin e të burgosurve dhe vazhdimin e negociatave, duke thënë se "çdo përparim hap rrugën për përparim të mëtejshëm". Megjithatë, ai paralajmëroi se nuk duhen humbur nga vëmendja interesat e kundërta të palëve.

Edhe pse ekspertët kanë vlerësime të ndryshme për shkallën e trysnisë me të cilën po përballet Rusia, analizat e tyre çojnë në një përfundim të përbashkët: pjesëmarrja e Moskës në negociata nuk do të thotë se Putini është i gatshëm të heqë dorë nga synimet e tij.

Siguria e Evropës

Ndoshta zhvillimi më i rëndësishëm i bisedimeve në Abu Dabi ishte përqendrimi gjithnjë e më i madh i Uashingtonit tek arkitektura më e gjerë e sigurisë evropiane.

Një zyrtar i lartë amerikan i tha Radios Evropa e Lirë se negociatorët amerikanë dëshirojnë të ulen me partnerët evropianë për t'i diskutuar marrëveshjet e sigurisë së kontinentit. Sipas tij, administrata amerikane ka qenë duke hartuar propozime në koordinim të ngushtë me partnerët, me synim forcimin e sigurisë afatgjatë të Ukrainës, mbrojtjen e sovranitetit të saj dhe kontributin në stabilitetin evropian.

Uashingtoni shpreson, gjithashtu, ta bindë Moskën të pranojë një format shumëpalësh negociatash, që potencialisht do t'i hapte rrugën pjesëmarrjes formale të Evropës. Kushner la të kuptohej se do të kërkonte miratimin e Putinit gjatë vizitës në Moskë.

Çështja është e ndjeshme, pasi Britania, Franca, Gjermania, NATO-ja dhe Komisioni Evropian nuk janë përfshirë në negociatat kryesore trepalëshe, ndonëse përfaqësues evropianë kanë qenë të pranishëm në margjinat e tyre.

Për Kievin shqetësimi nuk lidhet thjesht me protokollin diplomatik. Ukraina druhet se Uashingtoni dhe Moska mund të diskutojnë për të ardhmen e saj pa e përfshirë mjaftueshëm vetë Ukrainën, territori dhe sovraniteti i së cilës janë në diskutim.

Zelenskyy ka këmbëngulur se Evropa duhet të përfaqësohet në bisedime, duke argumentuar se vendimet për sigurinë evropiane nuk mund të merren pa qeveritë evropiane.

Zgjerimi i agjendës së negociatave ngre gjithashtu shqetësime për ambiciet strategjike të Moskës.

Rusia duket se po përpiqet ta përfshijë Uashingtonin në një diskutim shumë më të gjerë për rendin e sigurisë evropiane, gjë që potencialisht mund ta dobësojë aleancën transatlantike dhe ta zvogëlojë ndikimin e Evropës.

Sipas këtij interpretimi, negociatat nuk kanë të bëjnë më vetëm me Ukrainën, por edhe me marrëdhëniet strategjike mes Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe Rusisë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se kontaktet e tij me zyrtarët e NATO-s të përfshirë në bisedimet e Abu Dabit tregonin se Shtetet e Bashkuara, Ukraina dhe Evropa ishin "plotësisht të harmonizuara dhe të bashkuara". Megjithatë, ai theksoi se Rusia duhet të dëshmojë se është vërtet e gatshme të angazhohet në negociata.

Ndikimi i Uashingtonit në provë

Takimet e mundshme me Putinin dhe Zelenskyyn do të tregojnë nëse diplomacia mund të shkojë përtej diskutimeve paraprake dhe të prodhojë propozime konkrete.

Një problem thelbësor mbetet: nëse marrëveshjet e sigurisë për periudhën pas luftës nuk mund të zbatohen derisa të zgjidhen mosmarrëveshjet territoriale, çfarë garancish mund të marrë Ukraina përpara se të vendosë për territoret e pushtuara?

Për Kievin çdo marrëveshje që e lë vendin të pambrojtur ndaj një sulmi tjetër rus rrezikon ta shndërrojë armëpushimin në asgjë më shumë sesa një ndërprerje të përkohshme të konfliktit.

Zelenskyy tha në Dublin se Ukrainës i duhen "përgjigje shumë konkrete" për garancitë e sigurisë, duke shtuar se shumëçka do të varet nga Rusia, por edhe më shumë nga Shtetet e Bashkuara pasi, sipas tij, Ukraina "nuk po kërkon garanci sigurie nga Rusia, por nga Shtetet e Bashkuara".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Haxhiu: Kuvendi do të jetë pjesë e punës për cilësi më të mirë në shëndetësi



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, mori pjesë dhe mbajti fjalë në konferencën e parë ndërkombëtare për cilësinë e shërbimeve shëndetësore "Investojmë në cilësi - ndërtojmë besim", të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në këtë konferencë profesionistë dhe ekspertë nga Kosova dhe vendet partnere ndanë përvojat e tyre për cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

Në fjalën e saj, Haxhiu tha se cilësia e shërbimeve shëndetësore ka në qendër pacientin dhe se besimi i tij ndërtohet çdo ditë përmes mënyrës si dëgjohet dhe si trajtohet, nga vizita e parë te mjeku familjar, deri te trajtimet më të ndërlikuara spitalore.

Kryetarja e Kuvendit theksoi se mjekët dhe infermierët në Kosovë kanë dëshmuar përkushtimin e tyre edhe në periudhat më të vështira për vendin. "Puna e tyre kërkon aftësim të vazhdueshëm profesional, ndërsa qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë po investojnë në vazhdimësi për kushte më të mira pune. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 përcakton synime të qarta për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e qasjes në shërbime. Kuvendi do të jetë pjesë aktive e kësaj pune, në bashkëpunim me Ministrinë, profesionistët dhe përfaqësuesit e pacientëve", tha kryetarja Haxhiu.

GUVERNATORI ISMAILI TAKOI PRESIDENTEN SHIROKA-PULA: NË FOKUS STABILITETI FINANCIAR, HAPAT E ARDHSHËM PËR SEPA-N DHE PËRFITIMET E REFORMAVE PËR QYTETARËT DHE BIZNESET

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 12 nëntor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatorja Nesrin Shileku-Shala, zhvilloi një takim me presidenten e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula.

Në takimin e tyre të parë pas marrjes së detyrës nga presidentja, guvernatori Ismaili e uroi për detyrën dhe i dëshiroi sukses në ushtrimin e mandatit të saj kushtetues.

Guvernatori Ismaili e informoi presidenten për zhvillimet në sektorin financiar dhe për treguesit që pasqyrojnë qëndrueshmërinë e sektorit bankar. Ai theksoi rëndësinë e stabilitetit financiar për besimin e qytetarëve në institucionet financiare dhe për vazhdimësinë e financimit të ekonomisë.

Në takim u diskutuan edhe gjetjet e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën dhe vlerësimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, me fokus te progresi i reformave dhe prioritetet e identifikuara në këto vlerësime.

Pas dorëzimit të aplikimit të Kosovës për përfshirje në hapësirën gjeografike të Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), vëmendje e veçantë iu kushtua hapave të ardhshëm të procesit.

Guvernatori i BQK-së theksoi rëndësinë e mbështetjes institucionale dhe të angazhimit diplomatik me partnerët evropianë në fazat e ardhshme.

Përfshirja në SEPA pritet t'i lehtësojë transferet ndërkufitare në euro dhe t'i ulë kostot për qytetarët që dërgojnë ose pranojnë mjete nga jashtë, si dhe për bizneset që kryejnë pagesa me partnerët në tregun evropian.

Në kuadër të angazhimeve për integrimin ndërkombëtar të sektorit financiar, u diskutuan edhe mundësitë për përfshirjen e Kosovës në sistemin ndërkombëtar të sigurimit motorik të Kartonit të Gjelbër, si dhe bashkëpunimi me bankat qendrore partnere dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Guvernatori dhe zëvendësguvernatorja paraqitën prioritetet e agjendës legjislative dhe reformuese të BQK-së, duke përfshirë forcimin e mbikëqyrjes financiare dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian. Ata e informuan presidenten edhe për modernizimin e sistemeve të pagesave, përfshirë sistemin e pagesave të shpejta TIPS-K, i cili do t'u mundësojë qytetarëve dhe bizneseve të kryejnë dhe të pranojnë pagesa brenda pak sekondash dhe me kosto më të ulët.

Në takim u diskutua edhe agjenda e BQK-së për zgjerimin e qasjes në financa, me fokus te mundësitë e financimit për gratë ndërmarrëse.

Presidentja e Republikës shprehu vlerësimin për angazhimin dhe agjendën reformuese të BQK-së dhe vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, duke respektuar mandatet e tyre dhe pavarësinë kushtetuese të BQK-së.

Guvernatori Ismaili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për avancimin e nismave me interes për qytetarët dhe bizneset në përputhje me mandatet kushtetuese dhe ligjore të institucioneve.





Punëtorët e KEK-ut protestojnë, kërkojnë rritje të pagave dhe pagën e 13-të

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kanë protestuar të enjten. Ata kanë kërkuar rritje dhe nivelizim të pagave, gjithashtu edhe pagën e 13 për vitin 2026. Ata kanë kërkuar edhe përmirësim të kushteve të punës dhe vlerësim të rrezikshmërisë në vendet e tyre të punës.

Kryetari i Sindikatës së Re të KEK-ut, Xhelal Jashari, tha se punëtorët janë të pakënaqur me mosreflektimin e menaxhmentit ndaj kërkesave të tyre pavarësisht se ato janë adresuar vazhdimisht. Ai e cilësoi padrejtësi faktin që, sipas tij, punëtorët e KEK-ut nuk përfituan nga paga e 13 vitin e kaluar, ndonëse janë ndër sektorët që punojnë në kushte të rënda dhe me rrezikshmëri të lartë.





LIGJI PËR SPECIALEN RIKTHEHET NË KUVEND, DEPUTETËT DISKUTOJNË PËR RIMIRATIMIN E TIJ

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar do të jetë pikë e rendit të ditës në seancën parlamentare të së premtes. Partitë politike LV, PDK dhe Aleanca janë pajtuar për procedimin e tij drejt rimiratimit në Kuvend. Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se kanë marrë disa këshilla dhe rekomandime, të cilat, sipas saj, do ta bëjnë ligjin më të fuqishëm dhe juridikisht më të qëndrueshëm ndaj çdo kontestimi të mundshëm në fazat e mëtejshme

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka shqyrtuar të enjten vendimin e presidentes së Kosovës, Justina Pula-Shiroka, për kthimin në rishqyrtim të Ligjit nr. 11/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Pas diskutimeve u vendos që komisioni të hartojë një raport për seancën plenare, ku deputetët do të vendosin nëse do ta miratojnë projektligjin pa ndryshime, të kthyer nga presidentja Shiroka-Pula, me shumicën e nevojshme prej 61 votash.

Gjatë mbledhjes së Komisionit Legjislacion, deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, tha se partia e saj ishte pajtuar me shumicën parlamentare për rimiratimin e ligjit. Sipas saj, PDK-ja konsideronte se Rregullorja e Kuvendit lejonte ndryshimin e tekstit gjatë rishqyrtimit, ndërsa shumica parlamentare vlerësonte se ndryshimet nuk lejoheshin në këtë fazë. "Prandaj, unë dua të bëj të qartë që ne sot jemi në një situatë që duhet ta procedojmë ligjin për miratim në Kuvend në formën siç është. Pastaj ne do të nisim një proces të ri të amendamentimit të ligjit bashkë me kolegët deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës", tha Deliu-Kodra.

Përfaqësuesit e Vetëvendosjes në Komisionin për Legjislacion, Adnan Rrustemi dhe Vigan Qorolli, u shprehën në favor të një nisme të re ligjore.

Rrustemi tha se një nismë e re do të mund t'i adresonte shqetësimet që vetë PDK-ja kishte ngritur për tekstin. Qorolli, kryetar i komisionit, tha se PDK-ja ka të drejtë ta kërkojë rivotimin e të njëjtit tekst, por përsëriti kritikat ndaj nismës së miratuar më 6 tetor. "Do ta përsërisim sa herë që të jetë e nevojshme. Kjo iniciativë ka qenë e ngutshme, juridikisht e pamjaftueshme dhe pa ndonjë vlerë të mirëfilltë", tha Qorolli.

Sa i përket aktgjykimit të shkallës së parë ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së në Hagë, Rrustemi tha se grupi i tij parlamentar e sheh strategjinë shtetërore për apelin si rrugën për ta kundërshtuar atë.

Për hartimin e strategjisë, qeveria formoi më 14 tetor një grup punues, të kryesuar nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm, Glauk Konjufca. Grupi përfshin përfaqësues të institucioneve dhe të grupeve parlamentare. Sipas kryeministrit Albin Kurti, detyra e tij është ta bashkërendojë mbështetjen juridike dhe institucionale gjatë apelit.

Në seancën e së enjtes, me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së, shqyrtimi i këtij ligji ka hyrë në rendin e ditës së kësaj seance,

Këtë kërkesë e bëri deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, njëherësh ushtruese e detyrës së kryetares së kësaj partie. "Në emër të PDK-së, propozoj mocionin procedural për ndryshimin e rendit të ditës për të përfshirë edhe Ligjin për dhomat e specializuara", tha ajo.

Çitaku tha se u janë dhënë disa këshilla e rekomandime të cilat, sipas saj, ligjin do ta bëjnë më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm juridikisht nga kushdo që do ta kontestonte në fazat e mëtejme. Ajo tha se janë të vetëdijshëm se kjo mund t'ju kushtoj edhe politikisht por, sipas saj, qëllimi është më i rëndësishëm se dëmi që mund t'ju bëhet si parti. "E kemi marrë me bindje të plotë se mund të bëjmë ndryshime në të", tha ajo.

Çitaku kërkoi që sot të votohet ligji dhe pastaj të hënën të fillojë procedura e amendamentimit. "Ju ftoj që sot ta miratojmë Ligjin dhe menjëherë të hënën të fillojmë procedurën e amendamentimit dhe këtij procesi për të treguar seriozitet, t'i japim dy javë kohë...", tha ajo.

Çitaku u zotua se të hënën do ta sjellin nismën e re ligjore dhe brenda dy jave do t'i bëjnë ndryshimet.

Ky mocion ka kaluar me 79 vota për, duke hyrë si pikë e 11 e rendit të ditës.

Kuvendi pastaj mori një pauzë, por pas rinisjes së seancës, kryeparlamentarja Albulena Haxhiu nuk mundi që t'i vazhdojë punimet seanca pasi mungonin deputetët e mazhorancës. "Seanca i vazhdon punimet nesër në orën 11:00. Nuk është serioze që gjysmë ore pas orës 14:00 nuk po vijnë deputetët. Unë nuk kam mundësi të funksionoj dhe të pres deri në pafundësi", tha ajo.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, tha se grupi i tyre parlamentar do ta votojë sërish Ligjin për Specialen në versionin që Kuvendi miratoi më 6 tetor.

Ajo tha se LV-ja ka pasur dhe vazhdon t'i ketë rezervat dhe mospajtimet e caktuara lidhur me këtë ligj, por "nuk tërhiqet nga fjala e dhënë" për miratimin e tij.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës, Besnik Tahiri, ka kërkuar që Kuvendi i Kosovës ta procedojë sa më shpejt Ligjin për Dhomat e Specializuara, duke theksuar se vonesat e panevojshme mund të ndikojnë në humbjen e kohës për procesin gjyqësor në apel.

Në një deklarim në Komisionin për Legjislacion, Tahiri tha se, duke pasur parasysh afatet kohore të procesit gjyqësor në apel, Kuvendi duhet të veprojë me shpejtësi për ta përmbyllur këtë çështje. Ai theksoi se, sipas informacioneve që ka Aleanca, nuk ka ndonjë kërkesë për ndryshime shumë substanciale në ligj. "Duke pasur parasysh që procesi gjyqësor në apel e ka një afat kohor, sa më shumë që ne si Kuvend e vonojmë e tjerrim, aq më shumë humbim kohë. Dhe kjo është kërkesa jonë si grup parlamentar", ka deklaruar Tahiri.

Ai ka bërë me dije se Aleanca e mbështet Ligjin për Specialen, por kërkon që procedimi i tij të bëhet sa më shpejt. Për ta rimiratuar ligjin dhe për ta rrëzuar veton e presidentes Justina Shiroka-Pula duhen të paktën 61 vota.

Shiroka-Pula e ktheu ligjin për rishqyrtim më 22 tetor, me kërkesë të PDK-së. Komisioni për

→

KOMUNAT KËRKOJNË KOMPENSIMIN E DËMEVE NË BUJQËSI, THONË SE NUK KA PAGESA QË NGA VITI 2023



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Asociacioni i Komunave i Kosovës (AKK), në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi të komunës së Istogut, organizuan takimin e Kolegjiumit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ku u diskutuan problemet dhe nevojat e komunave në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Çështja kryesore e diskutimit ishte mungesa e kompensimit të dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore.

Përfaqësuesit e komunave shprehën shqetësimin se që nga viti 2023 nuk është realizuar asnjë kompensim për dëmet e evidentuara dhe se kërkesat e paraqitura nga komunat ende nuk janë shqyrtuar përfundimisht. Ata kërkuan sqarime për punën dhe funksionalitetin e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve si dhe për hapat që do të ndërmerren për trajtimin e kërkesave të mbetura.

Rasti i komunës së Istogut, me dëme të vlerësuara deri në 3 milionë euro, u theksua si tregues i përmasave të kësaj problematike dhe pamundësisë së komunave për t'i përballuar financiarisht dëmet e tilla.

Komunat kërkuan që kjo çështje ta marrë vëmendjen e nevojshme të institucioneve qendrore, veçanërisht të Zyrës së Kryeministrit, dhe që të zhvillohen konsultime të drejtpërdrejta me komunat për ta përcaktuar vlerën e përgjithshme të dëmeve dhe për të gjetur një zgjidhje konkrete për kompensimin e tyre.

U propozua që problematika të adresohet edhe pranë komisionit parlamentar përgjegjës.

Përveç kësaj, u trajtuan edhe dëmet e shkaktuara nga kafshët e egra, për të cilat u kërkua shqyrtimi i mekanizmave të kompensimit, mungesa e thirrjeve për grante dhe projekte të zhvillimit rural, mbështetja për rrugët fushore, si dhe shqetësimet e prodhuesve bujqësorë lidhur me trajtimin tatimor dhe eksportin e produkteve.

Në përfundim u vlerësua se këto problematika kërkojnë angazhim më të madh institucional dhe koordinim ndërmjet nivelit qendror dhe komunave në mënyrë që kërkesat legjitime të marrin zgjidhje konkrete dhe të sigurohet mbështetje më e qëndrueshme për sektorin e bujqësisë.

Në vijim të diskutimeve dhe shqyrtimit të kërkesave të komunave, AKK-ja do t'i adresojë këto shqetësime në nivel qendror përmes një shkrese zyrtare drejtuar ministrisë përkatëse, Zyrës së Kryeministrit dhe Komisionit Parlamentar përgjegjës.

Përmes saj do të kërkohet qartësi mbi statusin e kërkesave të komunave, punën e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve dhe masat e parapara për kompensimin e dëmeve në bujqësi.

Gjithashtu, do të kërkohet një takim i përbashkët me institucionet përgjegjëse dhe përfaqësuesit e komunave, me synim shqyrtimin e situatës dhe përcaktimin e hapave konkretë për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Kurti në Dublin u prit nga kryeministri i Irlandës



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në nisje të European Political Community (EPC) në Dublin, u prit nga kryeministri i Irlandës, Micheal Martin. "Jam shumë i lumtur të kthehem në Dublin pas tre vjetësh e gjysmë. Dua të falënderoj Taoiseach (kryeministrin) Micheál Martin për ftesën dhe mikpritjen.

Irlanda është rrëfim i shkëlqyeshëm suksesi i integrimit evropian dhe anëtarësimit. Republika e Kosovës gjithashtu dëshiron të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe në NATO, por për të arritur aty së pari duhet ta marrim statusin e vendit kandidat dhe t'i hapim negociatat për anëtarësim. Ne llogaritim në presidencën irlandeze. Dhe duam ta falënderojmë popullin e Irlandës për strehimin e më shumë se një mijë refugjatëve shqiptarë të Kosovës më 1999, kur u dëbuan nga mëmëdheu i tyre për shkak të gjenocidit të forcave të armatosura të Serbisë së Millosheviqit dhe Jugosllavisë", ka theksuar Kurti.

Ai i ka falënderuar ushtarët dhe oficerët irlandezë, të cilët kanë shërbyer në KFOR përgjatë këtyre më shumë se dy dekadave e gjysmë, për të siguruar paqe, siguri e mbrojtje për të gjithë qytetarët e vendit tim. "Bashkimi Evropian dhe NATO janë organizata të domosdoshme për demokraci, prosperitet dhe sigurinë e përgjithshme", ka deklaruar Kurti.

Legjislacion shqyrtoi vendimin e presidentes më 12 nëntor dhe do t'ia përcjellë çështjen seancës plenare.

Çfarë parasheh ligji?

Ndryshimi në Ligjin për Dhomat e Specializuara, i miratuar më 6 tetor, nuk parasheh shfuqizimin e Gjykatës Speciale, ku janë trajtuar disa raste për krime lufte dhe pengim të drejtësisë. Megjithatë, ai parasheh ndryshime për disa çështje kyç të funksionimit të gjykatës.

Një nga ndryshimet kryesore në ligjin e miratuar - e që u kthye mbrapsht nga presidentja - ka të bëjë me llojin e veprave që mund të trajtohen nga Specialja.

Ndryshimet parashohin lidhjen e juridiksionit të tyre me pretendimet për trafikim organesh të raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të vitit 2011 që ishte bërë shkas për krijimin e mekanizmit të drejtësisë në Hagë. Sipas ligjit, Specialja do të merrej me veprat që lidhen drejtpërdrejt me pretendimet për nxjerrjen, heqjen dhe trafikimin e paligjshëm të organeve, indeve ose qelizave njerëzore.

Në këtë juridiksion do të përfshiheshin edhe vrasjet, torturat si dhe trajtimi mizor e çnjerëzor në vendet specifike të ndalimit që përmenden në raport, kur ato lidhen drejtpërdrejt me operacionet e pretenduara të marrjes së organeve. Kjo i bie që ligji synon që Speciales t'i hiqet juridiksioni për t'i ndjekur krimet e tjera të luftës, krimeve kundër njerëzimit apo dhunës politike që nuk kanë një lidhje të tillë të drejtpërdrejtë. Po ashtu, një ndryshim tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me periudhën kohore. Sipas ligjit fillestar, Gjykata Speciale trajtonte krimet që pretendohet se janë kryer nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Ligji i propozuar nga PDK-ja, e i miratuar më 6 tetor, e kufizon këtë periudhë nga 1 korriku i vitit 1999 deri më 31 dhjetor 2000.

Po ashtu, me ndryshimet në ligj u kërkua që të trajtohen vetëm krimet që pretendohet se janë kryer në territorin e Kosovës e jo edhe në veri të Shqipërisë. Të gjitha rastet që nuk parashihen në juridiksionin e Speciale, me ndryshimin e ligjit, synohet të transferohen në Kosovë.

Po ashtu, aty parashihet që rastet që janë në procedurën e Gjykatës Supreme të transferohen në Kosovë.

Ndryshimet prekin edhe dënimin maksimal për personat që dënohen, duke kërkuar që ajo të jetë deri në 15 vjet burgim.

Po ashtu, të dënuarit nga Gjykata Speciale, sipas ndryshimeve të miratuara më 6 tetor, u mundësohet të jenë subjekt i faljes presidenciale. Por, kjo e fundit bie ndesh me ligjin aktual për faljen, që përjashton të drejtën e kërkimit të faljes presidenciale për vepra të caktuara kundër së drejtës ndërkombëtare, ndërsa Kodi Penal i Kosovës i përfshin krimet e luftës në këtë kategori.

Ligji është kundërshtuar nga komuniteti evropian, që ngriti shqetësime lidhur me detyrimet ndërkombëtare të Kosovës dhe pavarësinë e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

RAMA: E KRIJUAM NDËRMARRJEN E RE TË PASTRIMIT, QEVERIA NA BLLOKOI, POR NE GJEJMË ZGJIDHJE

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryeqyteti ka miratuar themelimin e ndërmarrjes së re komunale të pastrimit, por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka dhënë vlerësim negativ për këtë vendim, duke penguar, sipas kryetarit Përparim Rama, një zgjidhje të rëndësishme për menaxhimin e mbeturinave në Prishtinë.

Kryetari Rama ka kritikuar ashpër këtë vendim, duke theksuar se komunat e Obiliqit dhe Fushë-Kosovës kanë themeluar ndërmarrje të ngjashme, ndërsa një iniciativë e tillë po i pamundësohet kryeqytetit. "E krijuam kompaninë e re komunale të pastrimit, ashtu siç kanë vepruar edhe Obiliqi e Fushë-Kosova, por Prishtinën e bllokuan. MAPL-ja e ka kthyer vlerësimin negativ!", deklaroi Rama.

Kryetari rikujtoi se kjo nuk është pengesa e vetme nga niveli qendror. Sipas tij, edhe marrëveshja me KfW-në, në vlerë prej rreth 72 milionë eurosh, për sigurimin e 100 kamionëve shtesë dhe mijëra kontejnerëve, ka mbetur e bllokuar për shkak të mosnënshkrimit nga Ministri i Financave, Hekuran Murati.

Ai theksoi se këto projekte do të mundësonin përmirësimin afatgjatë të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa pasojat e bllokimit të tyre po i bartin drejtpërdrejt qytetarët. "Përderisa qeveria na bllokon vazhdimisht, çmimin po e paguajnë qytetarët e Prishtinës!", u shpreh Rama.

Përballë kësaj situate, kryeqyteti ka ndërmarrë masa alternative, duke angazhuar operatorë privatë, me mbështetjen e UNDP-së, për t'i dalë në ndihmë ndërmarrjes "Pastrimi" për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave.

Kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, së bashku me drejtorin e



Shërbimeve Publike, Leutrim Retkoceri, kanë dalë sot në terren për të përcjellë nga afër angazhimin e operatorëve privatë, të cilët tashmë kanë filluar pastrimin e qytetit. "Kemi ndërmarrë masa alternative dhe shtesë që, përmes sektorit privat dhe me ndihmën e UNDP-së, të vazhdojmë pastrimin e kryeqytetit. Për fat të keq, kemi një Qeveri e cila vazhdimisht bllokon projektet tona", deklaroi Rama.

Ai bëri me dije se kryeqyteti ka ndarë buxhet shtesë për angazhimin e operatorëve privatë, ndërsa kapacitetet e shtuara të kamionëve pritet të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e gjendjes me mbeturinat gjatë ditëve në vijim.

Kryetari Rama theksoi se, pavarësisht prej pengesave nga niveli qendror, kryeqyteti do të vazhdojë të gjejë zgjidhje për qytetarët. "Tentimet e tyre për bllokim dhe sabotazh asnjëherë nuk kanë arritur të na ndalin. Ne kemi vazhduar zhvillimin e kryeqytetit, i kemi tejkaluar sfidat dhe do ta tejkalojmë edhe këtë sfidë", theksoi ai.

Në fund, kryetari Rama falënderoi UNDP-në dhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen, si dhe qytetarët për durimin dhe mirëkuptimin e treguar, duke kërkuar falje për gjendjen e krijuar. "Bllokadat janë jashtë duarve tona, por pasojat po i përjetoni ju. Kryeqyteti nuk heq dorë nga qytetarët e vet", përfundoi Rama.

171 DITË ME NDOTJE MBI KUFIRIN E LEJUAR: AJRI QË THITH KOSOVA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Gati gjysmën e vitit me ndotje mbi kufijtë e lejuar. Kjo është pamja që del nga të dhënat e monitorimit të ajrit në Kosovë për vitin 2025.

Në rrjetin shtetëror të monitorimit u regjistruan 171 ditë me tejkalime të vlerës kufitare ditore për grimcat PM10 - ndotës që mund të depërtojnë në rrugët e frymëmarrjes dhe ta dëmtojnë shëndetin.

Të dhënat u bënë publike më 10 nëntor nga Avokati i Popullit, në një raport që paralajmëron se ndotja vazhdon të jetë ndër sfidat kryesore mjedisore dhe shëndetësore në vend.

Raporti, i mbështetur në të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, vëren se ndotja arrin nivelet më të larta kryesisht gjatë dimrit, kur rritet përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje.

Por, çfarë tregojnë këto shifra për ajrin që thithin qytetarët? Sa e rrezikuar është Kosova krahasuar me vendet e tjera evropiane? Dhe pse problemi vazhdon, pavarësisht prej paralajmërimeve të përsëritura?

Çfarë fshihet pas grimcave PM10 dhe PM2.5?

Ndotja e ajrit nuk është gjithmonë e dukshme. Ndër ndotësit më shqetësues janë grimcat e imëta të pezulluara në atmosferë, të njohura si PM10 dhe PM2.5. PM10 janë grimca me diametër deri në dhjetë mikrometra, ndërsa PM2.5 janë edhe më të vogla. Grimcat PM10 mund të hyjnë në sistemin e frymëmarrjes, ndërsa PM2.5 depërtojnë më thellë në mushkëri dhe mund të kalojnë edhe në qarkullimin e gjakut. Ekspozimi ndaj tyre lidhet me rritjen e rrezikut për sëmundje të mushkërive, probleme kardiovaskulare dhe vdekje të parakohshme.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), përqendrimi mesatar vjetor i PM2.5 nuk duhet të tejkalojë pesë mikrogramë për metër kub ajër. Për PM10, udhëzimi vjetor është 15 mikrogramë.

Pse ndotet ajri në Kosovë?

Burimet e ndotjes janë të shumta, por tri prej tyre dallohen: prodhimi i energjisë nga linjiti, ngrohja e shtëpive me dru e qymyr dhe transporti rrugor.

Termocentralet e Kosovës mbështeten në linjit, ndërsa shumë familje vazhdojnë të përdorin lëndë të ngurta djegëse për ngrohje.

Një vlerësim i OBSh-së për ndotjen e ajrit brenda shtëpive në Kosovë, i publikuar në vitin 2024, konstatoi lidhje të fortë mes përdorimit të drurit për ngrohje dhe shqetësimeve shëndetësore.

Raporti theksoi se mënyra e ngrohjes dhe gatimit ndikon ndjeshëm në cilësinë e ajrit që qytetarët thithin edhe brenda banesave.

Gjatë dimrit, kushtet atmosferike mund ta përkeqësojnë situatën. Kur ajri i ftohtë mbetet i bllokuar pranë tokës, ndotësit shpërndahen më ngadalë dhe përqendrimi i tyre rritet. Kjo shpjegon pse ndotja mund të arrijë nivele të larta pikërisht gjatë muajve kur kërkesa për ngrohje është më e madhe.

Si krahasohet Kosova me vendet e tjera?

Problemi nuk kufizohet vetëm në Kosovë. Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, gjatë vitit



2024, në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor u regjistruan përqendrime të PM2.5 mbi kufirin vjetor të Bashkimit Evropian.

Agjencia identifikon përdorimin e lëndëve të ngurta djegëse, industrinë dhe automjetet e vjetra si faktorë të rëndësishëm të ndotjes në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Një raport i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), i publikuar këtë vit, tregon se pasojat shëndetësore janë veçanërisht të rënda në Ballkanin Perëndimor.

Mesatarja rajonale ishte 126 vdekje të parakohshme për 100 mijë banorë, krahasuar me 39.5 në Bashkimin Evropian - më shumë se trefishi.

Maqedonia e Veriut kishte shkallën më të lartë të raportuar në rajon, me 146 vdekje për 100 mijë banorë, ndërsa Mali i Zi më të ulëtën, me 89.

Në një raport të publikuar më herët, edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës paralajmëroi për pasojat shëndetësore të ndotjes së ajrit dhe kërkoi, ndër të tjera, kontrolle më rigoroze teknike të automjeteve dhe monitorim të vazhdueshëm të filtrave të termocentraleve.

Pse nuk po zgjidhet problemi?

Avokati i Popullit nuk e sheh problemin vetëm te burimet e ndotjes, por edhe te mënyra se si institucionet përgjigjen ndaj tij.

Raporti evidenton mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe teknike për inspektim, dobësi në zbatimin e legjislacionit dhe nevojë për koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve.

Në vendet evropiane, masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit përfshijnë zgjerimin e sistemeve të ngrohjes qendrore, izolimin e ndërtesave, kufizimin e emetimeve industriale dhe zhvillimin e transportit më pak ndotës.

Për Kosovën këto masa kërkojnë investime afatgjata, por edhe zbatim të rregullave ekzistuese.

Avokati i Popullit kujton se mbrojtja e qytetarëve nga ndotja nuk është vetëm çështje e politikave mjedisore, por edhe detyrim i shtetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Radio Evropa e Lirë e pyeti Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për masat e ndërmarra kundër ndotjes së ajrit dhe planet për muajt e dimrit, por nuk mori përgjigje deri në publikimin e këtij artikulli.

Gjatë prezantimit të programit të Qeverisë në shtator, kryeministri Albin Kurti premtoi modernizimin e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B.

Kurti paralajmëroi, gjithashtu, zgjerimin e ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe vendosjen e saj në tetë komuna të tjera, si dhe investime prej 150 milionë eurosh në efiçiencë të energjisë për ndërtesa publike dhe familje.

RRITJA E BUXHETIT PËR SHËRBIME SOCIALE, DOMOSDOSHMËRI PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, GRAVE DHE FAMILJEVE

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF (me 35 organizata anëtare), Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (me 108 organizata anëtare), u janë drejtuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesën për adresimin e një çështjeje me rëndësi të veçantë për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, grave dhe familjeve në Kosovë: sigurimin e financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shërbimet sociale.

Në kuadër të diskutimeve dhe vendimmarrjes për buxhetin e vitit 2027, organizatat konsiderojnë se është thelbësore që financimi i shërbimeve sociale të trajtohet si prioritet publik dhe të reflektohet në vendimet buxhetore të Kuvendit.

"Vrasja tragjike e Arlinda Zekajt, pas raportimeve dhe kërkesave të përsëritura për mbrojtje, nënvizon nevojën urgjente për një reagim institucional efektiv ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Mbrojtja kërkon vlerësim të rrezikut në kohë, masa konkrete për sigurinë e viktimave, koordinim ndërinstitucional dhe qasje të vazhdueshme në shërbime të specializuara, përfshirë strehimin e sigurt, mbështetjen psikosociale dhe ndihmën juridike. Gjithashtu, vrasja e një foshnje tremuajshe në Gjilan nënvizon urgjencën për forcimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve. Identifikimi i hershëm i rrezikut, ndërhyrja në kohë dhe menaxhimi i koordinuar i rasteve duhet të mbështeten nga profesionistë të mjaftueshëm dhe shërbime që udhëhiqen nga interesi më i mirë i fëmijës", thuhet në reagimin e KOMF-it, duke shtuar se 38 Qendra për Punë Sociale dhe rreth 50 organizata joqeveritare të licencuara janë në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve sociale. "Megjithatë, ato përballen me kufizime të mëdha në burime njerëzore dhe financim. Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të jenë të mbingarkuara me trajtimin e rasteve emergjente. Aktualisht, një zyrtar i QPS-së në komunat e mëdha trajton rreth 350 lëndë aktive në vit. Organi i Kujdestarisë në shumicën e komunave nuk i ka të angazhuar të pesë profesionistët e kërkuar me ligj dhe nuk është funksional. Përveç mungesës së burimeve njerëzore, QPS-të përballen edhe me mungesë të theksuar të kushteve logjistike dhe infrastrukturore", theksohet në reagim.

Në anën tjetër, organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët, gratë dhe familjet në situata të cenueshme, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët dhe gratë viktima të abuzimit dhe dhunës, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, personat që përdorin drogë, si dhe kategori të tjera të qytetarëve në nevojë për mbrojtje, përballen vazhdimisht me rrezikun e ndërprerjes apo mbylljes së shërbimeve për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm. Sipas KOMF-it, kjo situatë rrezikon ta cenojë vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore dhe jetike, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien, sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. "Kërkesat e



adresuara drejt deputetëve janë: Të alokojnë buxhet të mjaftueshëm për Qendrat për Punë Sociale, në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve si pjesë e Grantit të Përgjithshëm të Qeverisë, për punësimin e 200 zyrtarëve të shërbimeve sociale (me fokus psikologë klinik) në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, me qëllim të plotësimit të kërkesave minimale ligjore për funksionalizimin e Organeve të Kujdestarisë, si dhe për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve logjistike të nevojshme, me qëllim të mundësimit të ofrimit të shërbimeve cilësore e në kohë për qytetarët. Kostoja shtesë e punësimit e 200 zyrtarëve të shërbimeve sociale në komunat e Kosovës do të ishte rreth 1.68 milionë euro në vit; Të alokojnë buxhet të mjaftueshëm për Qendrat për Punë Sociale, në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve si pjesë e Grantit të Përgjithshëm të Qeverisë, për punësimin e më shumë zyrtarëve të shërbimeve sociale të cilët do të kenë përgjegjësi specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kostoja shtesë e punësimit të dy zyrtarëve në çdo komunë, për rastet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje, do të ishte rreth 707,078 euro në vit për Qeverinë e Kosovës. Kjo shumë merr parasysh që Prishtina, si komuna më e madhe, do të kishte nevojë për katër zyrtarë të shërbimeve sociale. Rekomandojmë që kjo kërkesë të përfshihet nga të gjitha komunat në buxhetet e tyre, për zbatimin e kuadrit ligjor dhe të Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale; Të rrisin buxhetin e dedikuar për thirrjen publike për organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre. Linja aktuale buxhetore prej 2,500,000 euro ka mbetur e pandryshuar dhe mbulon të gjitha shërbimet sociale dhe familjare, duke përfshirë strehimoret, shërbimet në familje dhe shërbimet ditore. Sipas raportit 'Me çfarë kostoje?' publikuar nga RrGK, vetëm për mbulimin e shpenzimeve bazike të strehimoreve për viktimat e dhunës në familje nevojiten 2,339,631 euro. Ndërkaq, bazuar në të dhënat e organizatave anëtare të KOMF, shërbimet në familje dhe ato ditore aktualisht financohen mesatarisht vetëm në masën 25 % të kostove të tyre. Prandaj, bazuar në nevojat e evidentuara dhe analizat financiare, propozojmë rritjen e buxhetit aktual për thirrjen publike për organizatat e licencuara, nga 2,500,000 euro në së paku 5,000,000 euro në vit", është theksuar në reagimin e koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF.

AKK-ja U PËRCJELL DEPUTETËVE KËRKESAT E KOMUNAVE PËR PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2027

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Asociacioni i Komunave i Kosovës (AKK) ua ka përcjellë deputetëve të Kuvendit të Kosovës një sërë kërkesash lidhur me projektbuxhetin e vitit 2027, duke kërkuar ndryshime në ndarjet buxhetore për të siguruar financimin e shërbimeve komunale dhe vazhdimin e investimeve kapitale.

Në kërkesën e nënshkruar nga kryetari i AKK-së, Agim Aliu, thuhet se ndryshimet e propozuara synojnë edhe mbulimin e detyrimeve financiare të komunave nga politikat qendrore. Sipas analizës së AKK-së, për vitin 2027 parashihet rritje e të hyrave vetjake të komunave për 8.679.133 euro, njëkohësisht ulje e grantit për arsim për 8.991.013



euro dhe e grantit për shëndetësi për 1.658.839 euro krahasuar me vitin 2026.

Ndërkaq financimi nga huamarrja parashihet të rritet për 630.020 euro. AKK-ja vlerëson se ulja e kombinuar e granteve për arsim dhe shëndetësi arrin në 10.649.852 euro.

Një ndër çështjet e ngritura ka të bëjë edhe me zotimet shumëvjeçare dhe ndërlidhjen e sistemeve buxhetore SIMFK dhe BDMS. AKK-ja kërkon që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të paraqesë një plan me afate konkrete për ndërlidhjen funksionale të këtyre sistemeve, në mënyrë që të mundësohet regjistrimi dhe përcjellja e kontratave dhe zotimeve shumëvjeçare.

Po ashtu, kërkohet harmonizimi i ndarjeve buxhetore për vitet 2027-2029 me kontratat ekzistuese të komunave, me qëllim të shmangies së vonesave në pagesa, detyrimeve të papaguara dhe kostove shtesë.

Në dokument, Asociacioni kërkon edhe transparencë më të madhe në shpërndarjen e investimeve të ministrive sipas komunave, projekteve dhe burimeve të financimit.

Sipas analizës së AKK-së, janë identifikuar 303 projekte të ministrive me financim pozitiv për vitin 2027, në vlerë prej 168.291.390 eurosh. Megjithatë, thuhet se ky inventar nuk përfshin të gjitha buxhetet kapitale të ministrive dhe nuk paraqet një shpërndarje të plotë të projekteve kombëtare apo shumëkomunale.

Ndër kërkesat e tjera janë edhe përcaktimi i afateve dhe përgjegjësive për bartjen dhe vënien në dispozicion të të hyrave vetjake të komunave si dhe funksionalizimi i sistemit të tatimit në pronë.

AKK-ja u ka bërë thirrje deputetëve që gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit të vitit 2027 në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare t'i trajtojnë këto kërkesa dhe t'i mbështesin përmes amendamenteve përkatëse.

Gjithashtu, Asociacioni ka kërkuar organizimin e një dëgjimi të përbashkët me AKK-në, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Thesarin dhe ministritë përgjegjëse, para përfundimit të shqyrtimit të amendamenteve.

KPK-ja dhe ATK-ja diskutojnë për bashkëpunimin ndërinstitucional

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryesuesja e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Administrimin e Prokurorive në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Arlinda Muqa, së bashku me anëtarin e këtij Komisioni, Shkëlzen Ibrahimi, kanë vizituar të enjten Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), ku janë pritur nga drejtori i Përgjithshëm, Mentor Hyseni, drejtori i Departamentit të Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, Ferid Sylejmani, si dhe Shefi i Hetimeve, Fadil Revuçi.

Gjatë takimit përfaqësuesit e të dy institucioneve kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë përgjegjësitë dhe aktivitetet që ndërlidhen me veprimtarinë e tyre institucionale.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua mundësisë së avancimit të bashkëpunimit ndërmjet Administratës Tatimore të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit, me qëllim të rritjes së efikasitetit në trajtimin e çështjeve që kërkojnë koordinim ndërinstitucional.



Në këtë drejtim përfaqësuesit e ATK-së theksuan rëndësinë e trajtimit me prioritet të kërkesave të këtij institucioni nga prokuroritë përkatëse, në mënyrë që ATK-ja të mund t'i përmbushë me kohë dhe në mënyrë efektive obligimet dhe përgjegjësitë e saj ligjore.

Në përfundim të takimit, bashkëbiseduesit u pajtuan për nevojën e organizimit të një punëtorie të përbashkët ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurorit të Shtetit dhe Administratës Tatimore të Kosovës, në të cilën do të trajtohen format dhe mekanizmat konkretë të bashkëpunimit të mëtejshëm ndërinstitucional.

BQK-ja DHE OEK-u PARAQESIN RISITË NË SISTEMIN E PAGESAVE DHE PËRFITIMET PËR BIZNESET

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Në kuadër të takimeve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) me institucionet, partnerët dhe komunitetin e biznesit për informimin mbi reformat në sektorin financiar, guvernatori Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Dardan Fusha, zhvilloi një takim me përfaqësues të bizneseve në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK).

Paraprakisht guvernatori Ismaili u takua me kryetarin e OEK-së, Lulzim Rafuna, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Guvernatori Ismaili mbajti një prezantim mbi zhvillimet dhe reformat kryesore në sektorin financiar, me theks në modernizimin e sistemit të pagesave dhe integrimin financiar evropian.

Ai i informoi pjesëmarrësit për dorëzimin e aplikimit formal të Kosovës për përfshirje në hapësirën gjeografike të Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA).

Përfshirja në SEPA pritet t'i lehtësojë transferet ndërkufitare në euro dhe t'i ulë kostot e tyre, veçanërisht për bizneset që kryejnë pagesa dhe pranojnë mjete nga partnerët në tregun evropian.

Guvernatori Ismaili përmendi edhe avancimet në Sistemin Ndërbankar të Pagesave të Kosovës (KIPS), të zbatuara që nga fillimi i tetorit 2026, të cilat kanë përmirësuar efikasitetin dhe disponueshmërinë e sistemit.

Guvernatori Ismaili paraqiti, gjithashtu, zbatimin gradual të sistemit të pagesave të shpejta TIPS Kosova (TIPS-K).

Bankat që janë të gatshme do ta fillojnë ofrimin e shërbimeve më 23 nëntor 2026, ndërsa të gjitha bankat do të lidhen me sistemin deri më 23 shkurt 2027. Përmes



TIPS-K, bizneset që janë klientë të bankave pjesëmarrëse do të mund të kryejnë pagesa dhe të pranojnë mjete brenda pak sekondash, 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Kjo do t'ua lehtësojë pagesat ndaj furnitorëve, arkëtimet nga klientët dhe menaxhimin e likuiditetit.

Tarifat e reja për transferet bankare do të zbatohen nga 23 nëntori 2026 në të gjitha bankat, përfshirë ato që do të lidhen me TIPS-K gjatë periudhës kalimtare.

Pas lidhjes së të gjitha bankave, parashihet zgjerimi i pjesëmarrjes në sistem edhe për institucionet jobankare të pagesave dhe institucionet e parasë elektronike.

Gjatë vitit 2027 BQK-ja planifikon ta nisë zhvillimin e shërbimeve plotësuese mbi infrastrukturën e TIPS-K, me synim zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve të pagesave në dobi të ekonomisë.

Gjithashtu, u diskutua për zbatimin e reformave dhe ndikimin e tyre në veprimtarinë e bizneseve, ndërsa u adresuan pyetjet e pjesëmarrësve nga guvernatori dhe zëvendësguvernatori.

Në takim u vlerësuan lart bashkëpunimi ndërmjet BQK-së dhe OEK-së dhe angazhimi i BQK-së me komunitetin e biznesit. U përshëndetën reformat e BQK-së që sjellin përfitime të drejtpërdrejta për ndërmarrjet. U diskutua edhe për vazhdimin e bashkëpunimit në informimin e bizneseve dhe adresimin e çështjeve me interes për to gjatë zbatimit të reformave.

POSTA E KOSOVËS SHËNON 1,11 MILION EURO FITIM NË VITIN 2025

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, së bashku me kryeshefen ekzekutive të Postës së Kosovës, Nora Rraci dhe drejtorin e Njësisë për Ndërmarrje Publike, Dëfrim Pllashniku, kanë nënshkruar marrëveshjen për kompensimin e shërbimit universal postar, në vlerë prej 477 mijë eurosh, në përputhje me normat evropiane.

Shërbimi universal postar garanton që të gjithë qytetarët të kenë qasje në shërbimet e pranimit dhe dërgimit të letrave dhe pakove, brenda dhe jashtë vendit, me çmime të



përballueshme dhe të unifikuara, në të gjitha pikat postare dhe në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që çmimi i pullës postare për një kartolinë brenda Prishtinës është i njëjtë me atë për një kartolinë nga Leposaviqi në Brod të Sharrit.

Posta e Kosovës pritet që edhe këtë vit ta mbyllë me rezultat financiar pozitiv, duke shënuar kështu vitin e tretë radhazi me fitim. Ndërmarrja kishte arritur të dalë me fitim për herë të parë në vitin 2024, pas më shumë se një dekade nga themelimi si ndërmarrje e veçantë. Kurse gjatë vitit 2025 Posta e Kosovës ka shënuar 1,11 milion euro fitim, ndërsa auditori i jashtëm i ka dhënë opinion të pastër, pa vërejtje, për pasqyrat financiare të ndërmarrjes.

Nën udhëheqjen e kryeshefes Nora Rraci, Posta e Kosovës ka zgjeruar rrjetin e saj me hapjen e 43 zyrave të reja postare, ka investuar në teknologjinë informative dhe ka modernizuar flotën e automjeteve me mjete vetjake, duke siguruar shtatë furgonë, dhjetë vetura dhe 59 motoçikleta.

Këto rezultate dëshmojnë për përmirësimin e performancës financiare dhe operacionale të ndërmarrjes si dhe përkushtimin për ofrimin e shërbimeve postare cilësore dhe të qasshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ministria e Mjedisit nënshkruan memorandum me IUCN për mbrojtjen e natyrës

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Ministrja e Mjedisit, Fitore Pacolli, ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), për ta forcuar bashkëpunimin në mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit dhe avancimin e zonave të mbrojtura në Kosovë. "Në takimin me z. Oliver Avramoski, prezantova punën e Ministrisë së Mjedisit dhe diskutuam për mbështetjen profesionale, zbatimin e aktiviteteve mjedisore dhe mundësitë për sigurimin e fondeve në Kosovë përmes partnerëve ndërkombëtarë, përfshirë Suedinë dhe Gjermaninë. Ky memorandum hap rrugë për bashkëpunim konkret mes Kosovës dhe vendeve evropiane si dhe hap mundësi të reja për mbështetje ndërkombëtare në ruajtjen e pasurive tona natyrore", ka thënë ministrja Pacolli.



NGA VJENA TE HAREMI: SULEJMANI I MADHËRISHËM, HISTORIA E SULLTANIT QË TRONDITI EVROPËN

Për 46 vjet, Sulejmani i Madhërishëm udhëhoqi një nga perandoritë më të fuqishme të historisë. Fitoi beteja, ndryshoi ligje dhe e ktheu Stambollin në një qendër madhështie. Por pas mureve të pallatit, pushteti kishte një çmim tragjik





Në kulmin e fuqisë së tij, ushtritë e Sulejmanit të Madhërishëm kishin mbërritur deri në portat e Vjenës. Flotat osmane sfidonin rivalët në Mesdhe, ndërsa urdhrat e sulltanit ndiheshin nga Ballkani në Lindjen e Mesme. Për botën e krishterë ai ishte një sundimtar që ngjallte frikë dhe admirim. Për shumë prej nënshtetasve të tij ishte Kanuni, Ligjvënësi.

Megjithatë, historia e tij nuk është vetëm historia e pushtimeve. Është edhe rrëfimi i një burri që shkruante poezi dashurie, i besoi një miku pushtet të jashtëzakonshëm dhe, në fund, urdhëroi vdekjen e njerëzve të gjakut të vet.

Si u bë ky princ nga brigjet e Detit të Zi një prej sundimtarëve më të fuqishëm të shekullit XVI? Dhe pse mbretërimi i tij, i kujtuar si epokë e artë, u shënua nga kaq shumë tragjedi?

Nga Trabzoni në fronin osman: fëmijëria e një trashëgimtari

Sulejmani lindi më 1494 në Trabzon, qytet në bregun e Detit të Zi. Ishte djali i Selimit I, sundimtarit që do ta zgjeronte ndjeshëm Perandorinë Osmane me pushtimet në Siri dhe Egjipt.

Si pjesëtar i dinastisë, Sulejmani u përgatit që herët për të qeverisur. Edukimi i tij përfshinte gjuhët, fenë, letërsinë dhe administrimin, krahas formimit ushtarak. Por froni osman nuk ishte thjesht një trashëgimi: rivaliteti mes princërve mund të përfundonte me burgosje ose vrasje. Sigurimi i vazhdimësisë së pushtetit shpesh kishte përparësi ndaj lidhjeve familjare.

Kur Selimi I vdiq në shtator 1520, Sulejmani trashëgoi fronin në moshën rreth 26-vjeçare. Ai u bë sulltani i dhjetë osman. Askush nuk mund ta dinte ende se mbretërimi i tij do të zgjaste plot 46 vjet.

Beogradi, Rodosi dhe Mohácsi: fitoret që tronditën Europën

Sulejmani e tregoi shpejt se nuk synonte të qëndronte në hijen e të atit. Në vitin 1521 mori Beogradin, një pikë strategjike për hyrjen drejt Europës Qendrore. Një vit më vonë pushtoi Rodosin, duke dobësuar praninë e kalorësve të Shën Gjonit në Mesdheun Lindor.

Goditja vendimtare erdhi në 1526, në betejën e Mohácit, kur ushtria osmane mundi forcat hungareze dhe mbreti Luigji II humbi jetën. Fitorja ndryshoi ekuilibrat e pushtetit në Europën Qendrore dhe hapi një periudhë të gjatë rivaliteti mes osmanëve dhe Habsburgëve.

Në vitin 1529, Sulejmani rrethoi Vjenën. Qyteti rezistoi dhe fushata nuk arriti qëllimin e saj, por vetë prania e ushtrisë osmane atje dëshmoi përmasat e ambicies perandorake.

Në lindje, konflikti me dinastinë safavide e çoi ushtrinë osmane deri në Bagdad, të marrë më 1534. Sulejmani nuk shikonte vetëm drejt Europës: ai kërkonte të përcaktonte edhe ekuilibrin politik e fetar të Lindjes së Mesme.

Pse Sulejmani i Madhërishëm u quajt “Ligjvënësi”?

Në Perëndim hyri në histori si Sulejmani i Madhërishëm, emër që lidhej me pasurinë dhe shkëlqimin e oborrit të tij. Në traditën osmane njihej si Kanuni, Ligjvënësi.

Arsyeja ishte përpjekja për të sistemuar dhe harmonizuar ligjet perandorake me traditat juridike ekzistuese dhe me të drejtën islame. Rregullat për tokën, taksat, administrimin dhe çështje të tjera të jetës publike ndihmuan qeverisjen e një shteti me territore e popullsi shumë të ndryshme.

Megjithatë, nuk bëhej fjalë për barazi sipas kuptimit modern. Shoqëria osmane ishte hierarkike; komunitetet fetare kishin status dhe detyrime të ndryshme, ndërsa pushteti i sulltanit mbetej vendimtar. Madhështia e sistemit administrativ bashkëjetonte me dhunën e luftërave, taksat dhe praktikat e detyrueshme të rekrutimit.

Një perandori e shumë gjuhëve dhe besimeve

Stambolli i shekullit XVI ishte një metropol ku takoheshin tregtarë, ushtarë, diplomatë, zejtarë dhe besimtarë nga shumë popuj. Në hapësirën osmane jetonin turq, shqiptarë, grekë, sllavë, arabë, armenë, hebrenj dhe komunitete të tjera.

Ky diversitet ishte një burim fuqie ekonomike dhe administrative, por edhe një sfidë për qeverisjen. Bashkëjetesa nuk nënkuptonte mungesë diskriminimi apo konflikti: rendi osman u jepte komuniteteve hapësira për të ruajtur besimin dhe zakonet, por brenda një strukture të pabarabartë pushteti.

Në të njëjtën periudhë lulëzuan arkitektura, kaligrafia, artet dekorative dhe letërsia. Kryearkitekti Sinan la gjurmë të thella në peizazhin e perandorisë. Xhamia e Sulejmanijes në Stamboll mbetet një nga simbolet më të njohura të epokës.

Ibrahim Pasha: miku që u bë njeriu më i fuqishëm pas sulltanit

Një nga marrëdhëniet më të rëndësishme të jetës së Sulejmanit ishte ajo me Ibrahim Pashën. Me prejardhje të krishterë nga hapësira greke, Ibrahimi arriti të ngjitej në majat e administratës osmane dhe në vitin 1523 u emërua Vezir i Madh.

Ai u bë bashkëpunëtor, diplomat dhe komandant i rëndësishëm. Afërsia me sulltanin i dha autoritet të jashtëzakonshëm, por krijoi edhe rivalitete në oborr. Fuqia që e kishte ngritur aq lart do ta bënte gjithashtu të prekshëm.

Në vitin 1536, Sulejmani urdhëroi ekzekutimin e tij. Historianët kanë diskutuar për motivet: akumulimin e pushtetit, gabimet politike, rivalitetet dhe tensionet e pallatit. Të gjitha nuk mund të reduktohen në një komplot të vetëm. Për Sulejmanin, kjo ishte humbja e një bashkëpunëtori të pazëvendësueshëm, që dikur kishte qenë edhe mik.

Hyrrem Sulltana: dashuria që ndryshoi jetën e pallatit

Nëse Ibrahimi ishte njeriu i besuar i administratës, Hyrrem Sulltana, e njohur në Europë si Rokselana, u bë figura më e rëndësishme e jetës private të Sulejmanit.

E sjellë në pallat si skllave, me shumë gjasë nga Europa Lindore, ajo arriti një pozitë të pazakontë në oborrin osman. Sulejmani e mori për bashkëshorte, duke thyer një praktikë të konsoliduar dinastike. Hyrremi u bë nënë e disa fëmijëve të tij, mbajti korrespondencë politike dhe përfitoi nga një ndikim që shkonte përtej haremit.

Marrëdhënia e tyre la pas edhe poezi e letra që tregojnë një anë më intime të sulltanit. Por pallati ishte një vend ku afeksioni, trashëgimia dhe pushteti ndërthureshin vazhdimisht. Për këtë arsye, Hyrremi u përfshi shpesh në rrëfime për intriga. Duhet dalluar ajo që dokumentohet nga akuzat e kohës dhe legjendat e mëvonshme.

Tragjedia e princit Mustafa dhe lufta për trashëgiminë

Një nga episodet më të errëta të mbretërimit ndodhi në vitin 1553. Sulejmani urdhëroi ekzekutimin e djalit të tij, princit Mustafa, i cili kishte mbështetje të konsiderueshme mes ushtarëve dhe shihej si kandidat i fortë për fronin.

Akuzat për kërcënim ndaj pushtetit të sulltanit dhe rivaliteti për trashëgiminë e bënë situatën shpërthyese. Përfshirja e Hyrremit në ngjarje është debatuar gjatë, por nuk mund të paraqitet me siguri si shkaku i vetëm i vdekjes së Mustafait.

Pas vdekjes së Hyrremit në 1558, rivaliteti mes djemve të saj, Selimit dhe Bajazitit, u përshkallëzua. Sulejmani mbështeti Selimin. Bajaziti u ekzekutua në vitin 1561, së bashku me bijtë e tij. Ai që kishte sunduar në një perandori të madhe nuk kishte mundur të shmangte luftën brenda familjes.

Mesdheu osman: Barbarosa dhe beteja për kontrollin e detit

Sukseset e Sulejmanit nuk kufizoheshin në tokë. Nën komandën e admiralit Hajredin Barbarosa, flota osmane u kthye në një forcë vendimtare të Mesdheut.

→

Në betejën e Prevezës, më 1538, flota osmane fitoi ndaj një koalicioni të krishterë. Kjo forcoi pozicionin e osmanëve në Mesdheun Lindor dhe shtoi peshën e tyre në tregti e diplomaci. Madje aleancat nuk ndiqnin gjithnjë kufijtë fetarë: Franca e Françeskut I bashkëpunoi me osmanët kundër rivalëve Habsburgë.
Epoka e Sulejmanit ishte njëkohësisht kohë përplasjesh ushtarake dhe marrëveshjesh pragmatike. Europa dhe bota osmane jo vetëm luftonin, por edhe tregtonin, negocionin dhe ndikonin te njëra-tjetra.

Fundi i sulltanit: një vdekje në fushatë dhe një trashëgimi e ndërlikuar

Në vitin 1566, i moshuar dhe i rënduar nga sëmundjet, Sulejmani u nis sërish në fushatë. Ai vdiq në shtator, gjatë rrethimit të fortesës së Szigetvárit, në territorin e Hungarisë së sotme. Lajmi i vdekjes u mbajt përkohësisht i fshehtë për të ruajtur rendin në ushtri dhe kalimin e pushtetit.
Në fron erdhi Selimi II. Sulejmani u varros në Stamboll, pranë kompleksit të xhamisë që mban emrin e tij, ku ndodhet edhe mauzoleu i Hyrremit.
Çfarë la pas? Një perandori të zgjeruar, institucione më të konsoliduara dhe një trashëgimi kulturore që vazhdon të shihet edhe sot. Por la gjithashtu kujtimin e fushatave të përgjakshme, intrigave të oborrit dhe tragjedive të familjes sunduese.
Ndoshta këtu qëndron paradoksi i tij më i madh: Sulejmani mundi të ushtronte pushtet mbi territore të pafundme, por nuk arriti të siguronte paqe mes njerëzve më të afërt. Prandaj historia e tij mbetet më shumë se biografia e një pushtuesi. Është rrëfimi i çmimit njerëzor të madhështisë.



SI E KRIJOI TABLOIDI I SHEKULLIT XIX MITOLOGJINË E XHEK RRJEPËSIT

Pesë gra u vranë në Ist-End [East End] të Londrës në vitin 1888. Vrasësi nuk u identifikua kurrë. Një shekull më vonë, BBC pyeti nëse për këtë ishin fajtorë rrëfimet e gazetave dhe thashethemet

Nga: Fiona MACDONALD / BBC /



Më 9 nëntor 1888, u vra viktima e pestë dhe e fundit e Xhek Rrjepësit [Jack the Ripper] në lindje të Londrës. Në atë kohë, në Teatrin "Lyceum" të Londrës po jepej një produksion amerikan i Rastit të çuditshëm të dr. Xhekillit dhe z. Haidit [The Strange Case of Dr Jekyll and Mr Hyde] - dhe menaxheri i teatrit ishte Bram Stoker i cili po bëhej gati të fillonte të shkruante Drakulën [Dracula]. Një vit më parë, në dhjetor 1897, Sherlok Holmsi [Sherlock Holmes] i Arthur Conan Doyleit kishte bërë paraqitjen e tij të parë. Pikërisht në kontekstin e kësaj imagjinate të ethshme kolektive, një seri vrasjesh të egra do të kalonte nga fakti historik në sferën e legjendës.
Një shekull më vonë, në vitin 1988, BBC iu rikthye dosjeve origjinale të policisë dhe të Ministrisë së Brendshme - dhe pyeti nëse legjenda e kishte mjegulluar identitetin e vërtetë të vrasësit. Vrasjet vazhdojnë të magjepsin, pjesërisht sepse Xhek Rrjepësi nuk u identifikua kurrë dhe krimet mbeten të pazgjidhura - por, edhe për shkak të krijimit të mitit nga shtypi tabloid i epokës viktoriane, dhe në veçanti nga një redaktor që zhvillonte fushata.
Në një recension të novelës gotike të vitit 1886 Dr. Xhekilli dhe z. Haidi në një gazetë londineze, Pall Mall Gazette, një kritik shkroi: "Gërvishteni Xhon Bullin dhe do të gjeni një britanik të lashtë që kënaqet me gjak, që i pëlqen të zhytet thellë në vrasje dhe që përpin detajet e një varjeje." Gazette e lavdëroi gjithashtu versionin skenik të librit, i cili u hap në gusht 1888, duke veçuar skenat ku Haidi u hidhet grave.
"Ishte pothuajse profetike," i tha BBC-së në vitin 1988 Christopher Frayling, profesor i historisë kulturore në Kolegjin Mbretëror të Arteve [Royal College of Art]. "Brenda tri javësh, Gazette shkruante për një z. Haid që përgjonte Ist-Endin. Xhek Rrjepësi i Uajtçepelit [Whitechapel] dhe Dr. Xhekilli dhe z. Haidi, Xheku-me-thembra-suste [Spring-heeled Jack] dhe të gjithë tregtarët e frikës që popullonin gazetat e lira të sensacioneve [Penny Dreadfuls] dhe melodramat viktoriane - ishin ndërthurur në mënyrë të pazgjidhshme."
Aktori Richard Mansfield, i cili e kishte sjellë shfaqjen nga ShBA-ja në Londër, ishte aq bindës në interpretimin e dy roleve kryesore, saqë një spektator i shqetësuar i shkroi policisë duke sugjeruar se aktori mund të ishte Xhek Rrjepësi. Mansfield u përpoq ta rifitonte mbështetjen e publikut duke organizuar shfaqje bamirësie me komedi, ndërsa një gazetar shkroi: "Në Londër tani nuk ka fare dëshirë për tmerre në skenë. Ka mjaftueshëm jashtë saj për të na bërë të rrëqethemi."
Në tetor, Gazette botoi një letër ku thuhej se shfaqja kishte ndikuar te Xhek Rrjepësi. Megjithatë, mënyra se si vetë gazeta i trajtoi vrasjet ndoshta ishte pjesërisht përgjegjëse për atë që ndodhi më pas. Fraylingu argumentonte se, në vend që të kishte dalë nga lagjet e varfra të lindjes së Londrës, historia e Rrjepësit ishte zhvilluar në klubet e zotërinjve të Londrës perëndimore, ndërtuar nga shkruesit e gazetave mbi material të pakët.
Dhe, ishte vetë Gazette pjesërisht përgjegjëse për famën e keqe të Rrjepësit. Redaktori i saj, WT Stead, po eksperimentonte me një stil të ri sensacionalist i cili më vonë do të njihej si gazetari tabloide. Liberal dhe me ide të forta për reforma, ai kishte krijuar gjithashtu një armiqësi ndaj komisionerit të Policisë Metropolitane, Charles Warren, pas asaj që ai e konsideronte një dënim të padrejtë dhe përdorim të tepruar të forcës kundër protestuesve një vit më parë.

Aristokrat, mjek apo emigrant

Kur ndodhi vrasja e parë, më 31 gusht 1888, gazetat londineze - të udhëhequra nga Gazette - filluan ta lidhnin historinë me një varg çështjesh morale dhe shoqërore të kohës. Më 10 shtator, Gazette sugjeroi se vrasësi mund të ishte një aristokrat dekadent. "Ka një numër arsyesh pse komentuesit [në atë kohë] ... e përfytyronin Xhek Rrjepësin si xhentëlmen," i tha BBC-së prof. Judith Walkowitz, autore e librit Qyteti i kënaqësisë së tmerrshme: Rrëfime për rrezikun seksual në Londrën e vonë viktoriane [City of Dreadful Delight: Narratives of Sexual Danger in Late-Victorian London].
"Për të paktën 20 vjet kishte pasur agjitacion rreth çështjes së prostitucionit, fillimisht nga reformatorë moralë të klasës së mesme dhe agjitatoreve feministe ... dhe më pas kjo u intensifikua dhe u shtjellua në një ekspoze gazetareske të Steadit për prostitucionin e fëmijëve, në të cilën Steadi dokumentonte se si vajzat e varfra të popullit binin në grackë ... për kënaqësinë seksuale të zotërinjve të klasës së lartë."
Secila prej viktimave të Rrjepësit ishte detyruar të merrej me prostitucion për shkak të varfërisë. Redaktori - i cili do të vdiste në vitin 1912, në bordin e Titanikut - i përdori vrasjet si një mundësi për të nxjerrë në pah çështjet të cilat kërkonin reformë dhe për të bërë fushatë kundër veseve në shtresat e larta. Ato i dhanë gjithashtu mundësi ta sulmonte Warrenin sa herë që mundej, për shkak se ai nuk po bënte mjaftueshëm për ta gjetur vrasësin.
Shtypi filloi të spekulonte se, për shkak të mënyrës se si ishte përdorur thika mbi viktimat, vrasësi mund të ishte mjek - gjë që prekte frikën e asaj kohe ndaj kirurgëve. Ndërkaq, mediat konservatore drejtonin gishtin te lagjet e varfra të Ist-Endit, të banuara prej komuniteteve të emigrantëve.
Ky publicitet dhe sensacionalizëm i fuqishëm pati efekt të menjëhershëm, tha Frayling. "Vrasjet u kthyen në letërsi në po atë vjeshtë, në një lloj drame morale që vazhdon të ketë jehonë."
Ai zbuloi se kjo prirje kishte depërtuar madje edhe në hetimin policor, siç tregohet nga dosjet origjinale të ruajtura nga Ministria e Brendshme. Në pjesën më të madhe, ato përmbajnë "qindra letra nga njerëz të çuditshëm, shumë prej tyre të nënshkruara me emrin [Xhek Rrjepësi] - i cili u përhap shumë shpejt, i shkruar në mënyra të ndryshme."
Por, ekziston një memorandum i një oficeri të lartë policie, i shkruar në vitin 1894, pasi çështja ishte mbyllur, ku përmenden tre të dyshuar. Megjithatë, edhe ky duket se ishte ndikuar nga zhurma e madhe mediatike. "Është provë e fortë për ekzistencën e tri miteve të qëndrueshme, dhe jo për identitetin e Xhek Rrjepësit," argumentonte Frayling.
I dyshuari i parë i përmendur nga kreu i Skotland-Jardit [Scotland Yard], Melville Macnaghten, ishte Montague Druitt, një avokat për të cilin detektivi mendonte se ishte mjek. Trupi i tij u gjet duke pluskuar në lumin e Temzës në dhjetor 1888, pak pas vrasjes së fundit. I dyti ishte berberi Aaron Kosminski, një emigrant hebre polak në Uajtçepel, i cili vdiq në një azil psikiatrik në vitin 1899. Dhe, i treti ishte Michael Ostrog, një mjek rus dhe ish-i dënuar.
"Këta janë të vetmit tre të dyshuar që përmenden seriozisht në të gjithë dosjen e policisë dhe nuk ka ndonjë provë policore që ia vlen të përmendet në mbështetje të tyre," tha Frayling. "Shihni se si përputhen me gjithë ata aristokratë, të huaj dhe mjekë që shtypi i përmendte në vitin 1888 si pjesë të fushatave të veta ... A është ky vërtet përfundimi i peshuar i një ndjekjeje për kapjen e vrasësit, apo janë thashethemet e klubeve? Dhe, a ishte policia aq e përfshirë në mitologjinë e vitit 1888 saqë edhe ajo po kërkonte personazhe të dala nga gazetat e lira të sensacioneve, melodramat viktoriane dhe fushatat e shtypit?"
Me pak fjalë, argumentonte Frayling, kushdo që përpiqej të zbulonte identitetin e Xhek Rrjepësit mund të kishte kërkuar në drejtimin e gabuar. Dhe, e njëjta gjë ka vlejtur që atëherë edhe për studiuesit e Xhek Rrjepësit. "Ne duam të dëshmojnë se Rrjepësi ishte aristokrat dekadent një artist bohem, ose homoseksual, ose emigrant, ose i çmendur," tha ai. Në të vërtetë, vrasësi mund të mos i përshtatej asnjërës prej këtyre kategorive të rregullta, sensacionaliste. Kushdo që i vrau ato pesë gra, ai nuk ishte "personazhi i shpikur nga shtypi, policia dhe shoqëria viktoriane."
/Telegrafi/



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Rashica në janar largohet nga Beshiktashi?



STAMBOLL, 12 NËNTOR - Milot Rashica do të jetë lojtari i parë që do të largohet nga skuadra e Beshiktashit në afatin kalimtar të janarit, kanë raportuar mediumet në Turqi. Largimi i Rashicës vjen pasi trajneri i Beshiktashit, Vincenzo Italiano, nuk llogarit në shërbimet e tij, duke e bërë sulmuesin e krahut lojtarin e parë jashtë planeve të ekipit. Madje drejtuesit e klubit tashmë kanë vendosur t'ia lehtësojnë Rashicës transferimin diku tjetër, duke mos kërkuar dëmshpërblim për kartonin e tij.

Rashica ka kontratë deri në qershorin e vitit të ardhshëm, të cilën Beshiktashi mund t'ia ndërpresë në janar nëse futbollisti nga Kosova nuk e pranon largimin si lojtar i lirë. Me largimin e Rashicës në janar, Beshiktashi do ta përdorë kuotën e lojtarit të huaj për të bërë një përforcim në repartin e mbrojtjes. 30-vjeçari është pjesë e Beshiktashit që nga viti 2023 dhe në sezonin aktual ka shënuar një gol në tetë paraqitje në të gjitha garat.

SAHITI ZBULON OBJEKTIVIN E KOSOVËS: SË PAKU KATËR PIKË NË DY NDESHJET E FUNDIT PËR TA SIGURUAR VENDIN E DYTË



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Drejtori i Kombëtares së Kosovës në futboll, Muharrem Sahiti, ka thënë se objektivi i Dardanëve në dy ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve është të grumbullojnë së paku katër pikë, në mënyrë që ta sigurojnë pozitën e dytë në Grupin B3. Para ndeshjes të së shtunës kundër Izraelit, Sahiti ka vlerësuar atmosferën në kampin e Kosovës, duke thënë se futbollistët dhe stafi teknik janë duke punuar me përkushtim për këto dy përballje vendimtare.

"Atmosfera jashtëzakonisht e mirë. Djemtë janë duke punuar mirë dhe stafi është jashtëzakonisht i përkushtuar për të përgatitur futbollistë për këto dy ndeshje shumë të rëndësishme. E para është me Izraelin, një ndeshje jashtëzakonisht e rëndësishme për ne, jo vetëm për të siguruar mbetjen në Ligën B, por edhe për pretendimet që së paku të jemi në vendin e dytë e që ajo vendi i dytë na mundëson edhe të jemi në vazon 2 për shortin e kualifikimeve. Kështu që është atmosfera e mirë, djemtë janë me plot energji, kështu që të presim. Sidoqoftë, planifikimet tona janë edhe të stafit që së paku në këto dy ndeshje minimum të kemi katër pikë për të siguruar vendin e dytë së paku. Kështu që, po pretendojmë se do t'ia dalim", është shprehur Sahiti për "Kosovapress"-in.

Një çështje tjetër e diskutuar është mundësia që futbollistët e rinj, të ftuar për herë të parë nga selektori Franco Foda, të debutojnë në këto dy ndeshje. Sahiti ka thënë se vendimi për minutazhin dhe aktivizimin e tyre i takon vetëm selektorit dhe stafit të tij. Sa i përket gjendjes së repartit defensiv, drejtori i Kombëtares ka pranuar se Kosova përballet me mungesa të rëndësishme, por ka shprehur besimin se stafi teknik do t'i gjejë zgjidhjet e duhura. Ai ka veçuar edhe rikthimin e Kreshnik Hajrizit dhe ardhjen e Kamberit si alternativa për mbrojtjen.

"Ardhja e Kamberit, kemi mbrojtës të tjerë të cilët selektori do t'i vendosë. Edhe si zakonisht edhe përkundër asaj që kemi pasur edhe në të kaluarën mungesa, por që ia ka dalë të bëjë zëvendësimet e duhura, po shpresojmë që edhe për këto ndeshje të gjejë zëvendësimet për t'i zëvendësuar edhe për këtë detyrë në mënyrën sa më të mirë të mundshme", ka deklaruar Sahiti.

Sahiti është ndalur edhe te situata e Edon Zhegrovës te Juventusi, duke vlerësuar se futbollistit të Kosovës nuk po i jepet hapësira e merituar në klubin italian. Ai ka shprehur bindjen se Zhegrova mund të japë kontribut të rëndësishëm për Dardanët në dy ndeshjet e ardhshme. "Të tjerët janë jashtëzakonisht në formë, edhe nëpër klube, nuk kemi çfarë flasim për Vedatin, pos aspekteve sportive është edhe një kapiten, një lider i cili di të menaxhojë situatën me gjithë futbollistët, qoftë në fushë, qoftë jashtë fushës. E për Edonin (Zhegrovën), po e shohim edhe ne që kemi vlerësuar, për mendimin tim është një padrejtësi që është duke u bërë në klub. Kur aktivizohet ai bën një ndryshim, një diferencë në skuadër, prandaj po shpresoj që edhe kontributi i tyre do të jetë i madh në këto dy ndeshje", ka thënë Sahiti.

Kosova do të përballet me Izraelin të shtunën, në kuadër të xhiros së pestë të Ligës së Kombeve, ndërsa ndeshjen e fundit të këtij edicioni do ta zhvillojë kundër Irlandës. Objektivi i Dardanëve është të përfundojnë sa më lart në grup, me pozitën e dytë që do t'u mundësonte të ishin në vazon e dytë për shortin e kualifikimeve të ardhshme.

GASHANI PRANON VËSHTIRËSITË NË ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHETARE "PRISHTINA 2030"



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Ministri i Sportit dhe Rinisë, Blerim Gashani, ka pranuar se organizimi i Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030" po përballet me vështirësi dhe vonesa, të shkaktuara nga jostabiliteti institucional dhe problemet në komunikimin ndërinstitucional. Duke folur në Kuvendin e Kosovës, Gashani ka thënë se periudha dyvjeçare e jostabilitetit ka ndikuar negativisht në përgatitjet për këtë ngjarje sportive. Ai ka theksuar se Ligji për Lojërat Mesdhetare nuk ishte miratuar për 15 muaj, ndërsa pas marrjes së mandatit është proceduar me dinamikë të shpejtë. "Po ju tregoj qe po, kemi shqetësime, kemi vështirësi sepse ka pasur jostabilitet dhe ai dyvjeçar ka shkaktuar edhe vonesa dhe vështirësi edhe në Lojërat Mesdhetare. Që t'i përmendim vetëm disa nga ato, 15 muaj Ligji për Lojërat Mesdhetare nuk është aprovuar dhe sapo kemi marrë mandatin, me dinamikë shumë të shpejtë kemi proceduar e pastaj ka derivuar edhe formimi i Komitetit Organizativ dhe po vazhdojmë me intensitet të plotë", ka deklaruar Gashani.

Ministri ka pranuar se vështirësi ka edhe në komunikimin me Komitetin Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), duke përmendur mospajtimet dhe fërkimet e brendshme si dhe mungesën e një qeverie të plotë.

Një tjetër shqetësim i ngritur prej tij lidhet me mosrespektimin, gjatë vitit 2025, të parimit të përfshirjes gjeografike të të gjitha pjesëve të Kosovës në organizimin e Lojërave Mesdhetare.

Manchester Unitedi shkarkon Michael Carrickun



MANCHESTER, 12 NËNTOR - Manchester Unitedi ka konfirmuar largimin e Michael Carrickut nga posti i trajnerit të ekipit të parë, duke i dhënë fund periudhës së tij në krye të skuadrës angleze. Përmes një komunikate zyrtare, klubi nga "Old Trafford" ka bërë me dije se ka marrë vendimin për t'i ndarë rrugët me trajnerin anglez, pas një fillimi zhgënjyes të sezonit 2026/27. Carricku ishte rikthyer në klub në muajin janar dhe arriti ta udhëhiqte Manchester Unitedin drejt pozitës së tretë në Ligën Premiere në sezonin 2025/26. Nën drejtimin e tij, skuadra fitoi 12 nga 17 ndeshjet e mbetura të kampionatit, duke grumbulluar më shumë pikë se çdo ekip tjetër gjatë asaj periudhe. Megjithatë, rezultatet jo të mira në fillim të sezonit të ri kanë bërë që drejtuesit e klubit ta marrin vendimin për ndryshimin e trajnerit, me synimin për t'i arritur objektivat e vendosura. Manchester Unitedi ka treguar se synon ta emërojë sa më shpejt trajnerin e ri të përhershëm, i cili do ta marrë drejtimin e skuadrës për vazhdimin e sezonit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Valoni - Gërgoc" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810239881 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Valoni - Gërgoc" D.O.O. sa sjedištem u Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810239881 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Valoni - Gërgoc" L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 810239881 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Ermali" Sh.p.k. Deçan për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë:10.12.2026, në ora:10:00h, në hapësirat e Restaurant LEO, në fshatin, Shishman, Gjakove, do të organizohet debat publik nga operatori "Ermali" Sh.p.k., Deçan, për Leje Mjedisore, me nr. prot. 25/8856/MMPH, për seperimin e inerteve në Shishman- Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
https://us04web.zoom.us/j/4568731576?pwd=xFtnVeXXQaJwNfDlla8lo3n25OtMf6.1
Meeting ID: 456 873 1576
Passcode: mQ7kmg
Linku i Komunës:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

Ermali" Sh.p.k.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES